

**Fjala e Kryetarit të Prezencës pas takimit me Prokuroren e Përgjithshme, Zj. Ina Rama, 20 Maj 2011**

Pjesë e mandatit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri është edhe mbajtja e kontakteve të rregullta me institucionet e këtij vendi dhe ky ishte qëllimi i kësaj vizite. Shteti i së drejtës është jashtëzakonisht i rëndësishëm në të gjitha proceset, sidomos në proceset me shumë interes për qytetarët. Ngjarje të rëndësishme kanë ndodhur këtu në këtë vend që prej muajit janar 2011, disa prej të cilave kërkojnë një shqyrtim ligjor dhe analizë juridike, dhe kjo analizë e pavarur përbën një gjë shumë të rëndësishme. Ky është një proces shumë i rëndësishëm dhe Prokuroria e Përgjithshme po punon për këtë.

Është shumë e rëndësishme që shteti i së drejtës në këtë vend, në Shqipëri, do të thotë gjithashtu se askush nuk duhet të dalë mbi ligjin; ligji duhet të jetë saktësisht njësoj për të gjithë dhe duhet të zbatohet njësoj për të gjithë. Por kryesore është që institucionet kryesore të shtetit parashikuar në Kushtetutën e vendit të mund të punojnë në mënyrë të pavarur dhe siç duhet, pa presione nga jashtë. Unë shoh një nivel të lartë të punës profesionale dhe e përsëris se të punuarit në mënyrë të pavarur është jashtëzakonisht i rëndësishëm, po aq sa i rëndësishëm është edhe respektimi i Kushtetutës, ligjeve të Shqipërisë dhe respektimi i punës së individëve që punojnë në këto institucione. Ajo që është e rëndësishme tani është transparenca e vazhdueshme që sigurohet përmes medieve dhe tani po i referohem procesit pas-zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Edhe aty, nevojitet të punohet profesionalisht e në mënyrë të pavarur duke u bazuar vetëm në shtetin e së drejtës. E përsëris se askush nuk duhet të qëndrojë mbi ligjin dhe bëj thirrje për respektim reciprok, duke filluar me respektimin e ligjit, por duke respektuar gjithashtu edhe punën e mirë të policisë. Faleminderit!